



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Pritje/Prodato Received/Delivery	14.11.2022	viti god year	2022
Organ /Njësia Organ /Jednitca Org./Unit	Nr. Prot Pril. Pril. Prot No	Shtojca Prillog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHKOK	7081/2022		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.838/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.838/2022 të datës 30.09.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë [redacted] kundër organit të punësimit/Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 ,nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 14.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.838/2022 e datës 30.09.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

II. Obligohet Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të inicioj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin e koeficientit të nëpunës civilë [redacted] nga koeficienti shtatë (7) në koeficientin tetë (8).

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] është e punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, sipas Akt emërimit të datës 11.10.2012 në pozitën "Zyrtare e lartë për çështje juridike", në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë. Me datën 09.09.2022 përmes shkresës me numër 01-120/04-0084350/22, i është drejtuar me kërkesë Zyrës së Personelit në Komunën e Mitrovicës, lidhur me harmonizimin



e koeficientit nga 7 në 8. Ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore të kësaj komune me datën 26.09.2022 përmes shkresës me numër 01-120/04-0084350-2/22 i është përgjigjur ankueses lidhur me kërkesën e saj për harmonizimin e koeficientit dhe e ka refuzuar të njëjtën.

E pakënaqur me përgjigjen e Komunës së Mitrovicës së Jugut konkretisht Zyrës së Burimeve Njerëzore, me datën 28.09.2022 përmes Postës së Kosovës ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 5778/2022 për në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në Këshill është pranuar me datën 30.09.2022, me pretendimet ankimore lidhur me harmonizimin e koeficientit nga shtatë(7) në tetë (8), bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe Rregullores (QRK) Nr.26/20 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 10.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 6001/2022 në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Ndërsa Këshilli, me datën 17.10.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës nga Komuna e Mitrovicës së Jugut.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5778/2022 të datës 30.09.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Ndryshim plotësimin e akt emërimit me numër 01-101/03-0047494/22 për ankuesen të datës 15.06.2021; Formularin e përshkrimit të detyrave të punës për ankuesen të datës 24.09.2012; Organogramin e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë në Komunën e Mitrovicës së Jugut; Kërkesën e ankueses me numër 01-120/04-0084350/22 të datës 09.09.2022 e parashtruar tek Komuna e Mitrovicës së Jugut lidhur me harmonizimin e koeficientit; Përgjigjen në kërkesë me numër 01-120/04-0084350-2/22 të datës 26.09.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës së Jugut; Certifikatën e ankueses të muajit tetor për vitin 2017 nga USAID dhe AUK; Letër rekomandimin e datës 20.02.2017 Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës së Jugut për ankuesen; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 10.10.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 17.10.2022 nga Komuna e Mitrovicës së Jugut së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës; Fletë dorëzimin e datës 27.09.2022; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses dhe Akt emërimit e ankueses të datës 11.10.2012; Kërkesën përmes e-mailat zyrtar të datës 07.10.2022 nga KPMSHC për DMZP-në si dhe Përgjigjen përmes e-mailit zyrtar të 10.11.2022, nga DMZP për Këshillin.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses, **është e bazuar, SEPSE:**

Lidhur me pretendimin e ankueses për harmonizim të koeficientit të pagës nga shtatë (7) në tetë (8) për pozitën të cilën e mban si "Zyrtare e lartë për çështje juridike", Kolegji ju referua nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë në të cilin është përcaktuar se: "Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave", si dhe nenit 3 paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë më të cilin parashihet se:



“Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, përmes emalit të datës 09.11.2022 i është drejtuar Zëvendës Drejtoreshës në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik lidhur me sqarimin e pozitës së ankueses, se me çfarë koeficienti duhet të paguhet “Zyrtarët e Lartë Ligjorë”, ku bënë pjesë edhe pozita e ankueses si “Zyrtare e lartë për Çështje juridike”, ndërsa kjo e fundit përmes emalit me numër të protokollit 7005/2022 të datës 10.11.2022 ka sqaruar se, citoj: “Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, duke u bazuar në Rregulloren (QRK) Nr.26/2020 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil dhe katalogut të vendeve të punës është përcaktuar, si vijon: pozita Zyrtar i Lartë ligjor, klasa: profesional 1, koeficienti i pagës është 8, ndërsa pozita/titulli i vendit të punës, duhet të jetë i barasolershëm, i unifikuar, për shkak të detyrave dhe përgjegjësi, si dhe në pajtim me ligjin e buxhetit vjetor për organizatën përkatëse buxhetore”.

Andaj mbi këtë bazë ligjore e nisur nga konstatimi si më lartë se ankuesja është e emëruar në pozitën si “Zyrtare e lartë për çështje juridike”, në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë me koeficient shtatë (7) të pagës, si dhe duke u bazuar në shkresën e datës 10.11.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik si organ përgjegjës për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për pagat e zyrtarëve publikë, me të cilën është konfirmuar se pozita e ankueses bënë pjesë në klasën profesional 1 dhe ka të përcaktuar koeficientin tetë (8) të pagës, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimor i ankueses për harmonizimin e koeficientit të pagës me titullin e punës është i drejtë dhe i bazuar sipas legjislacionit në fuqi.

Ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankueses si më lartë, Kolegji duke u bazuar në provat e lëndës ka gjetur se Komuna e Mitrovicës së Jugut konform kërkesës së ankueses të datës 09.09.2022 lidhur me harmonizimin e koeficientit prej shtatë (7) në tetë (8), të njëjtën e ka refuzuar me datën 26.09.2022, andaj mbi bazën e këtyre fakteve rrjedhë se mos harmonizimi-zbatimi i koeficientëve të ndryshëm të pagës për pozitë të njëjtë të punës sipas Rregullores Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, rrjedhimisht në gjykimin e Kolegjit veprimet e tilla bien ndesh edhe me dispozitat e nenit 2 dhe 4 të Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrotjtje nga Diskriminimi si dhe nenin 7 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin parashihet se: “Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-technikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë...”.

Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon e ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.838/2022, datë 14.11.2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses: [REDACTED]
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.